



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 19 Prill 2021

Nr: 252

VENDIM

- Objekt:** Për shqyrtimin e denoncimit për shkelje të parashikuar në udhëzimin nr. 6, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ndaj z. Isuf Çelaj , Kryetari i Partisë Demokratike, Dega Tropojë
- Kërkues:** Z. Altin Berbati
- Ndaj:** Z. Isuf Çelaj, Kryetar i Partisë Demokratike, Dega Tropojë
- Baza ligjore:** Nenet 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të shqyrtimit administrativ,

VËREN:

I

Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një kallëzim në email denoncime.kqz@gmail.com, për veprimtarinë e kryetarit të Partisë Demokratike, Dega Tropojë



z. Isuf Çelaj, i cili gjatë fushatës së kandidatit për deputet z. Petrit Malaj, ka shpërndarë materiale propagandistike në kundërshtim me udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Në kallëzimin e raportuar më datë 10.04.2021, ora 03:26, protokolluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 3715 prot., datë 13.04.2021, pretendohet se: “*Partia Demokratike, dega Tropojë me kryetar z. Isuf Çelaj kanë shkelur Kodin Zgjedhor neni 79, pika 2 gjithashtu dhe vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tropojë nr. 64 datë 06.04.2021 “Për përcaktimin e vendeve publike në territorin e bashkisë Tropojë”*”. Bashkangjitur denoncimit, si provë është dërguar linku, <https://lexo.com.al/2021/04/09/pamje-per-te-mos-u-humbur-tenton-te-prishe-takimin-e-ps-me-dron-deshton-plani-i-demokrateve-ne-tropoje/> ku shihet valvitja e flamurit të Partisë Demokratike, me anë të një droni.

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e organit publik për shqyrtimin e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

- dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;
- f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;
- n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Referuar denoncimit të mësipërm, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se neni 79, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve rregullon sjelljen e subjekteve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, në lidhje **me materialet propaganduese statike**. Bazuar në nenin 2, pika 31 “Materiale propaganduese statike janë materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë **vendosur ose afishuar** në vende ose **hapësira publike me akses publik**, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse etj.

Referuar nenit 8, të vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në rastet kur KQZ nuk është organi kompetent dhe/ose nëse mungojnë indiciet e besueshme për të nisur hetimin administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vendos refuzimin për nisjen e hetimit administrativ.

Sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve çmon se të dhënat e paraqitura nga z. Altin Berbati, nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme dhe indicie të besueshme për të filluar një procedurë administrative.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9/2020 dhe vendimit nr.9/2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

